



REPUBLICA E KOSOVES-REPUBLIK E KOSOVA
KUVENDI I KOMUNITETIT MALISHEVE
THE MUNICIPAL ASSEMBLY MALISHEVE

PRANUAR ME:
ACCEPTED ON:
PRIMLJENO:

15/05/2024

Mbledhje
01/598



REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E MALISHEVES

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

PROQESVERBALI

Komuna: Malishevë

Data e mbajtjes së takimit të KKS-së: 04.04.2024

Nr. rendor i takimit për këtë vit: II -

Numri i anëtarëve të pranishëm të KKS-së: 17

Lloji i takimit: I rregullt

Takimin e kryeson: Ekrem KASTRATI, Kryetar i Komunes së Malishevës
Mysafir apo zyrtar të ftuar në takim: KFOR-LMT, ZKI

Rendi i ditës:

1. Miratimi proqesverbalit të mbledhjes të kaluar,
2. Miratimi i rendit të ditës,
3. Vlerësim mbi qeshjen e sigurisë në komunën e Malishevës,
4. Gjendja aktuale e Shërbimeve Emergjente në Komunën e Malishevës: përgaditja për sezonin Veror (ZJARRRET, ETHKK, Etj),
5. Të ndryshme

Tema shitesë: Nuk ka

Proqesverbali dhe Rendi i ditës: Miratohet unanimisht

2. Ekrem KASTRATI: Kryesues i KKS-së, Ju përshtendes, dhe ju falenderoj për pjesëmarrje në takimin e dytë të KKS-së, pasi që koordinatori i KKS-së konstatoi prezencën e anëtarëve në kourum, e hapi këtë takim, me rendin e ditës si në Ftesë. Ju lutem, a ka dikush të shtoj ndonjë pikë shtesë?, nëse jo, atëherë kush është për këtë rend të ditës? Ju lutem që më ngritje dore, kush është për? Ju falenderoj, konstatohet unanimisht.
Me qenëse, unanimisht e miratua rendin e ditës për këtë takim, kalojmë në pikën e parë, e ajo është; Miratimi proqesverbalit të mbledhjes të kaluar,
A deshiron dikush ta merr fjalën lidhur me proqesverbalin mbledhjes së kaluar?, në jo, atëherë shkojmë me votim me ngritje dore, kush është për?, ju falenderoj, konstatohet unanimisht i takimit të kaluar të KKS-së miratohet unanimisht.
Falënderoj, kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës, e ajo është; Vlerësimi mbi qeshjen e sigurisë në Komunën e Malishevës, për këtë pikë ftoj Komandantin e Stacionit Policor në

Malishevë z. Azem KRASNIOI, të na jepë informate mbi qeshjen e sigurisë së përgjithshme publike në komunën tonë?

z. Azem KRASNIOI, Komandant i Stacionit Policor në Malishevë; Falemenderit i nderuari Kryesues i KKS-së, përshëndetje për ju anëtarë të KKS-së dhe ju të pranishëm. Për sa i përket situatës së përgjithshme publike në komunën tonë, vlerësoj se ajo është e qetë dhe stabile dhe se mund të jemi të kënaqur me këtë gjendje të sigurisë. Krahasuar me tre mujorin e vitit të kaluar, ky tremujor është më i qetë për sa i përket kryerjes së veprave penale.

z. Ekrem KASTRATI, falemenderit K-dant, për këto informata dhe punën që po e bëni në ruajtjen e sigurisë në komunën tone. Nëse deshiron dilush ta marr fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës. Për fjalë paraqitet Zj. Feride HOXHÀ. Feride HOXHÀ.

Zj. Feride HOXHÀ, Falemenderit i nderuari Kryesues i KKS-së, përshëndetje për ju anëtarë të KKS-së dhe ju të pranishëm, Falemenderoj organet e rendit për punën e tyre në ruajtjen e kësaj gjendje të mirë të sigurisë, megjithëse jam e shqetësuar për paraqitjen e rasteve të dhunës në familje e sidomos për rastin e dhunimit të një vajze 13 vjeqare vitin e kaluar.

z. Ekrem KASTRATI, Falemenderit e nderuar Zj. HOXHÀ, për fjalë paraqitet z. Azem KRASNIOI, urdhëroni Komandant i Stacionit Policor në Malishevë.

z. Azem KRASNIOI, edhe për sa i përket kësaj dukurie negative dhe shumë të dëmshme për komunitetin dhe krejtë shqetërimë në përgjithësi, siq është dhuna në familje, posaçërisht ndaj të miturve, komuna jonë në krahasim me komunat tjera qendron shumë më mirë dhe më stabile.

z. Ekrem KASTRATI, Falemenderit Komandant, a deshiron edhe dikush ta marr fjalën. Po për fjalë paraqitet z. Amrush HELSHANI, Urdhëro z. HELSHANI e keni fjalën.

z. Amrush HELSHANI, Komiteti Komunal për Komunitet, Falemenderit i nderuari Kryesues i KKS-së, përshëndetje për ju anëtarë të KKS-së dhe ju të pranishëm. Ndjehem i shqetësuar për disa raste të disa nxënësve për përdorimin e armëve në shkolle, dhe vërejtjes së nuk ka patrulla të mjaftueshme të Policisë nëpër shkolle.

z. Azem KRASNIOI, Policia e Kosovës është prezente dhe patrullon në qdo vend duke parandaluar rastet e tilla, por jo edhe në abjektet shkollore, ne nuk jemi shtet policor, për brenda hapstrave të objekteve shkollore janë edhe institucionet tjera, si menaxhmenti i shkolles, Këshilli i Prindërve, etj.

KONKLUZION: "KKS-ja në Malishevë vlerëson se, situata e sigurisë së përgjithshme publike është e mirë dhe stabile".

Kush është për këtë konkluzion. Ju Falemenderit, konstatoj se Konkluzioni miratohet unanimisht nga anëtarët e KKS-së.

Atëherë, kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditë e ajo është: Gjendja aktuale e Sherbimeve Emergjente në Komunën e Malishevës: përgaditja për sezonin Veror (ZJARRRET, ETHKK, Etj.). Për këtë pike ftoj z. Shqipron SHALA, Drejtor i DMSH që të na informoj, urdhëro z. SHALA.

z. Shqipron SHALA, Falemenderit i nderuari Kryesues i KKS-së, përshëndetje për ju anëtarë të KKS-së dhe ju të pranishëm. Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, gjatë kësaj periudhe, ka qenë

bartëse e aktivitetëve në përgaditëjen dhe menaxhimin e emergjencave lokale në territorin e Komunës së Malishevës, dhe e cila ka menaxhuar me Shërbimet Emergjente Komunalet për mënyrë të përshtatshme, sektorëve mvarës në kryerjen e punëve dhe detyrave të parashtritura sipas planit të punës për vitin 2024, dhe në përpunueshmëri me Ligjin, Udhëzimet dhe Urdhëresat administrative që janë në fuqi. Të gjitha sektorët e kësaj Drejtorie i kanë kryer punët dhe detyrat e veta të parashtrura, në kohë dhe me sukses.

Gjatë kësaj periudhe, përkundër rasteve emergjente që kanë ndodhur, e që si pasojë e tyre, nuk pasur humbje jete në njerëz, por vetëm dëme jo të konsiderueshme në të mira material, dhe që nuk pasur nevojë për aktivizimin e POEL, duke realizuar aktivitetet si në vijim, dhe atë në:

Mirëmbajtjen e Planëve Emergjente për komunën e Malishevës,
Mbajtjen e Cadishumërisë së personelit të Drejtorisë dhe (ERE) Ekipeve për Reagim, gjatë situatave Emergjente, dhe OQ-ve (Organizata Qeveritare), të përfaqësuar në KKMSH (Komitetin Komunal për Mbrojtje dhe Shpëtim-Shitab),

Inspektimin e rasteve Emergjente, (zjarreve, vërshimeve, aksidentëve etj) dhe shkaktarëve të reziqëve, (shembje dheu dhe rrezikët e tjera), duke dhënë rekomandime dhe kërkesa, Hartimin e Plan-Projektit për themelimin e SKMSHN-së (Struktura Komunalet për Mbrojtje, Shpëtim dhe Ndihmë),

Përgjigjeja ndaj kërkesave të qytetarëve, etj.

Ndërsa, për sa i përket intervenimeve të NJPZSH-të gjatë kësaj periudhe, gjegjësisht prej fillimit të vitit 2024, gjatë kësaj periudhe, 39 raste, prej të cilave 20 raste të zjarreve Malore, 3 Fushore, 3 aksidente në trafik, 3 zjarre elektrike etj, në të cilat, përveç dëmeve në të mirat materiale dhe tjera nuk pasur. Sektori i Emergjencave, krahas aktivitetëve të lartcekura, ka filluar në përgaditjen për sezonin veror, ndërsa fokusi do të jetë në implementimin e projektit në spërkajën nga toka të zonave endemike kundër EHKK dhe në themelimin e Njësitit për MSHN për zjarret. Dua të shpreh shqetësimin për mungesën e stafit dhe mjeteve të NJPZSH, njëkohësisht shfrytëzoj rastin të falënderoj të gjithë udhëheqësit e shërbimeve emergjente për bashkëpunimin dhe koordinimin. Dhe krejt në fund, dua të theksoj se me gjithë mungesat humane apo teknike, jemi të gatshëm që të menaxhojmë me emergjencë qofshin ato natyrore apo të tjera në komunën tonë.

z. Ekrem KASTRATI, Falenderit për informata të shërbimeve Emergjente të Komunës sonë, sa i përket problematikës së Rriqërave, ato veq kan filluar të shfaqen, dhe se kemi disa raste të evidentuara të pickimit por që fatmirësisht nuk ka asnjë rast të infektimit, kurse në krahasim me të njëjten periudhë të vitit të kaluar situata paraqitet shumë më e mirë dhe se procedurat e prokurimit veq kan filluar për spërkajën e zonave endemike kundër EHKK. Gjithëseshtu, dua të ju informoj se veq kam biseduar me Ministrin e MBPZHR lidhur me Repelimin e kafshëve që është për gjegjësi e nivelit qendror, gjë që kishite me gen mir të bëhet edhe repelimin i kafshëve në vendin tonë.

Pasi që nuk paraqitet askush për diskutim rreth kësaj pike të rendit të ditës, propozoj që të nxjerrim një konkluzion lidhur me shërbimet emergjente në komunën tonë.

KONKLUZION: "KKSb-ja vlerëson se, me gjithë kapacitetin e limituar shumane dhe teknike gjendja e shërbimeve emergjente në komunën e Malishevës, është e mirë dhe në gjendje për të reaguar në emergjencë natyrore dhe të tjera."

Kush është për këtë konkluzion, ju lutem me ngrihtë dore, Falenderit, konstatoj që Konkluzioni u miratua unanimsisht.

z. Ekrem KASTRATI, kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës, e cila është: Të ndyeshme: A ka dikush nga anëtarët ndonjë pyetje, sygjërim apo me shu diqka?

z. Amrushi HELSHANI, Komiteti Komunal për Komunitete: Falemendërit i nderuar Kryesues i KKS-së, deshiroj që të ju Përgëzoj për ndërtimin e 10 shtëpive, një ndër të është për komunitetin pakicë. Gjithashtu, dua të shpreh shqetësimin për hudhjen e mbeturinave nëpër fshatra në vende të pajtuara.

z. Ekrem KASTRATI, Falemendërit z. HELSHANI, për për kontributin tuaj, a ka edhe dikush që don me marr fjalën. Fjalën e ka Zj. Feride HOXHIA.

Zj. Feride HOXHIA, HANDIKOS: Falemendërit i nderuar Kryesues i KKS-së. Me qenës, njerëzit që po bohen, dhe kryesisht afër rrugës dhe trovarëve, mjete të cilave mund të rrezikojnë nënësit, si dhe vendparkingjet për persona me aftësi të kufizuara.

z. Ekrem KASTRATI, Falemendërit e nderuar zj. Hoxha. A deshiroj edhe dikush ta marr fjalën lidhur me këtë pikë të rendit të ditës. Për ta marr fjalën paraqitet z. Sead PAÇARIZI, BIK,

urdhëroni z. PAÇARIZI e keni fjalën.

Sead PAÇARIZI, BIK, Falemendërit, përshëndetja për të gjithë, lidhur me fillimin e regjistrimit të popullatës, ne si Bashkësi Islame e Kosovës kemi marr rekomandim që në Hultën e Xhumasë të flasim për rëndësinë dhe pjesëmarrjen e të gjithëve në regjistrimin e popullatës, njëkohësisht deshiroj të falemendërit komunen e Malishevës për bashkëpunimin në ndërtimin e 2 shtëpive.

z. Ekrem KASTRATI, Falemendërit i nderuar z. PAÇARIZI për kontributin dhe punën tuaj.

Nëse nuk paraqitet edhe dikush për ta marr fjalën, Unë falemendërit për diskutimet dhe kontributin e dhënë në këtë takim. Për a përkele ndërtimëve të larta, ne si nivel lokal nuk kemi mundësi sanksionimi të nderësve, ato janë kompetencë e nivelit qendror, kurse për regjistrimin e popullsisë që fillon nesër, kërkoj nga të gjithë ju që të apeloni të qytetarët që të regjistrohen për të mirën e vendit të tone dhe se ndihmon vendin me statistika për 10 vitet e ardhshme.

Gjithashtu ju njoftoj se së shpejti do të vazhdojnë punimet në qendër të aytezës, ku do të ketë edhe bllokun të rrugëve, gjë që nevojitet bashkëpunim dhe mirëkuptim me qytetarët.

Me qenës jemi në fund të agjërimit të Ramazanit, shfrytëzoj rastin tuar qytetarët e Komunes së Malishevës, Urimë festa e Fitër Bajramit, dhe kërkoj në fund, propozoj që nga ky takim të dalim me rekomandim dhe atë;

- "Gjendja e sigurisë së përgjithshme publike në komunën tone është e mir dhe stabile, kërkohet angazhimi maksimal nga të gjitha subjektet e sigurisë për ruajtjen e kësaj niveli të sigurisë në komunën tone, posaçërisht gjatë kryerjes së punimeve në infrastrukturë".

Rekomandimi miratohet unanimisht nga anëtarët e KKS-së.

Procesverbali u përpilua nga Koordinatori i KKS-së:

Procesverbali aprovohet nga Kryesuesi i KKS-së:

29.04.2024
Malishevë

